

Informacion Mujor – Gusht 2022

Emri i Fondit	Fondi i Pensioneve Vullnetare SIGAL
Struktura Ligjore	Fond Pensioni* Licensuar nga AMF me licensë nr. 2, datë 30.03.2011
Administrimi i Fondit	Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive "SIGAL Life UNIQA GROUP AUSTRIA" Sh.a.
Themeluar	Janar 2006
Monedha	Lekë
Banka Depozitare	Banka Amerikane e Investimeve Sh.a.
Auditues	Grant Thornton Sh.p.k.

*Rregulluar nga Ligji nr. 10 197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar"

Komision në Hyrje	0%
Komision në Dalje	0%
Komision Vjetor Administrimi	2.20%
Penalitet për tërheqje të parakohshme	Sipas Rregullores së AMF
Komision Performance	0%
Shuma fillestare e kuotës	1.000 Lekë
Kontributi fillestar minimal	1.000 Lekë
Kontributi minimal pasues	1.000 Lekë

Objektivat dhe Politika e Investimit

Objektivat e Investimit

Fondi i Pensioneve ka për qëllim të maksimizojë kthimin afatgjatë të investimit nëpërmjet administrimit të kujdesshëm dhe konservator të rrezikut të investimit.

Politika e Investimit

Asetet e Fondit do të investohen me synim për të rritur kthimin nga investimi për anëtarët e tij dhe për t'ju siguruar atyre një të ardhme të sigurt.

Instrumentat në përbërjen e portofolit janë: (i) tituj të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, me maturitete të ndryshme, (ii) mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre dhe (iii) Depozita me afat në banka të nivelit të dytë të licencuara nga Banka e Shqipërisë.

Të dhënat kryesore për Fondin në 31 Gusht 2022

Vlera Neto e Aseteve	2,354,100,620.72 Lekë
Numri i anëtarëve	9953
Çmimi i Kuotës	1,579.7251 Lekë
*Fitimi vjetor (31/08/21-31/08/22)	3.79%
**Kohëzgjatja	4.60

*Komisioni i administrimit zbritet përpara llogaritjes së kthimit nga investimi
**Kohëzgjatja në datën e raportimit 31.08.2022

Portfoli i Investimeve në datën 31 Gusht 2022




Figura 1-Përbërja e portofolit sipas kategorive





Figura 2-Përbërja e portofolit sipas maturitetit të mbetur

Profili i Rrezikut dhe Përfitimit



Profili i Rrezikut dhe Përfitimit të Fondit tregon luhatshmërinë historike të çmimit të kuotës.

Për Fondin e Pensioneve Vullnetare "SIGAL" treguesi është në nivelin 1, ose nivel më i ulët i rrezikut.

Fondi ndodhet në këtë kategori pasi portfoli i investimeve është në pjesën kryesore të tij në Tituj të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë.

Treguesi është i bazuar në të dhënat historike të 5 viteve të fundit dhe kategoria e rrezikut mund të ndryshojë në të ardhmen.

Performanca e Fondit

Performanca e Fondit deri në 31.08.2022

Gjatë muajit Gusht 2022 çmimi i kuotës dhe Vlera Neto e Aseteve të Fondit kanë patur një trend rritës. Norma e rritjes të çmimit të kuotës për këtë muaj ka rezultuar 0.287%.

Fitimi vjetor neto (%) për 12 muajt e fundit (Periudha: 31 Gusht 2021 – 31 Gusht 2022) ka shënuar nivelin 3.79%. Fitimi i 3 mujorit të dytë të 2022 ka rezultuar në nivelin 0.79%.

Rekomandohet që anëtarët të qëndrojnë sa më gjatë në fond në mënyrë që të përfitojnë maksimalisht nga kthimi i investimit.


Performanca vjetore (%)

	2017	2018	2019	2020	2021
Fondi	4.55	4.30	4.17	3.53	3.67


Rritja e Vlerës Neto të Aseteve (%)

	2018-2019	2019-2020	2020-2021
Fondi	22.20	19.45	28.37


Fitim vjetor neto (%)



Ecuria e Çmimit të Kuotës



Ecuria e Tregut të Titujve të Qeverisë Shqiptare



Tregu i Titujve të Qeverisë Shqiptare është karakterizuar nga një trend rritës për titujt për të cilët janë organizuar ankande gjatë këtij muaji. Raporti mesatar i mbulimit në ankandet e këtij muaji ka rezultuar 1.08 në rënie nga 1.18 raport mbulimi gjatë muajit Korrik 2022.

Rendimenti i Bonove 12-mujore të Thesarit gjatë muajit Gusht arriti nivelin 3.472% nga 2.837%, me një rritje prej 0.635%. Obligacioni 2 vjeçar ka rezultuar me rendiment 4.20% nga 2.90% me rritje prej 1.3% krahasuar me ankandin paraardhës.

Për obligacionin 3 vjeçar rendimenti ka shënuar nivelin 4.937% nga 3.67% me një rritje prej 1.267% krahasuar me ankandin paraardhës.

Për obligacionet e maturiteteve 5, 7, 10 dhe 15 vjeçare nuk janë zhvilluar ankande gjatë këtij muaji, ndërkohë në ankandet paraardhëse, këto tituj kanë rezultuar me rendiment përkatësisht në nivelet 4.747%, 5.00%, 6.25% dhe 6.90%.

Informacion Praktik

Trajtimi Fiskal

Fondi është një grup asetesh, i krijuar në bazë kontrate dhe pa personalitet juridik, për rrjedhojë nuk i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat, ose taksës mbi vlerën e shtuar. Trajtimi fiskal i kontributeve të bëra nga anëtarët bazohet në nenet 88, 89 dhe 90 të ligjit nr.10 197, datë 10.12.2009 "Për Fondet e Pensioneve Vullnetare". Lidhur me detajet referojuni seksionit "Tatimi" të Prospektit të Fondit.

Deklaratë

Ky dokument ofron informacione kryesore për anëtarët në lidhje me Fondin e Pensioneve Vullnetare "SIGAL". Anëtarët këshillohen dhe janë të ftuar të lexojnë Prospektin e Fondit në mënyrë që të marrin një vendim të mirë informuar. Informacioni i përditësuar mbi çmimin e kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Fondit të Pensionit Vullnetar "SIGAL" dhe në <https://fondisigal.com.al/>

Kontakt:

Rr. "Ukraina e Lirë", Tiranë

Email: info@fondisigal.com.al

Tel: +355 (0) 44 511 666